

RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2021

**"Fiskalizimi,
një zgjidhje
për informalitetin
apo një kosto
shtesë për
biznesin?!"**

AUTOR

ANILA SALIANJI



QENDRESA
QYTETARE



NED

www.qeverisja.qq.com.al

PËRMBATJA:

1. Çfarë është reforma e fiskalizimit?
2. Ecuria e procesit të fiskalizimit
3. Rezultatet e arritura dhe rezultatet e pritshme nga fiskalizimi
4. Problematikat e shfaqura gjatë zbatimit të fiskalizimit
5. Kostot e fiskalizimit për biznesin e vogël
6. Gjetje kryesore
7. Rekomandime

1. ÇFARË ËSHTË REFORMA E FISKALIZIMI?

Në datën 18 dhjetor 2019 u miatua nga Parlamenti ligji nr. 87/2019, "Për faturimin elektronik dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i cili u publikua në Fletoren Zyrtare më 20 janar 2020. Ligji parashikonte një kombinim të teknologjisë dhe rregulloreve duke i dhënë mundësinë autoriteteve tatimore shqiptare të monitorojnë qarkullimin e tatimpaguesve në kohë reale. Sipas ëebsite-t të administratës tatimore, "fiskalizimi" është një reformë që ka për qëllim të reduktojë informalitetin, apo siç quhet ndryshe, masën e ekonomisë "gri". Ligji për fiskalizimin është një ligj tërësisht i ri që nuk zëvendëson asnjë ligj ekzistues të ngjashëm me të. Për t'a shpjeguar më qartë, *fiskalizimi është raportimi në kohë reale i informacionit tatimor dhe nënkupton një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit tatimor, sidomos në fushën e lëshimit të faturave dhe gjurmimit të shpenzimeve*. Kjo përfshin një tërësi masash që tatimpaguesit duhet të zbatojnë për lëshimin e faturave në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

Proçesi i fiskalizimit ka si qëllim të reduktojë evazionin fiskal në transaksionet me dhe pa para në dorë, duke monitoruar dhe kontrolluar qarkullimin e të gjitha transaksioneve si edhe të lëvizjeve të mallrave dhe shërbimeve.

Ky është një process kompleks që përfshin:

- Ndryshimin e kornizës ligjore
- Zbatimin e teknologjive të reja
- Riorganizimin e administratës tatimore
- Gjithëpërfshirjen dhe krijimin e një filozofie të re menaxhimi dhe administrimi fiskal

2. ECURIA E PROCESIT TË FISKALIZIMIT

Procesi i fiskalizimit ishte parashikuar të ndahej në tre faza:

- Faza e parë (B2G), e cila përfshinte përpilimin elektronikisht të faturave tatimore për subjektet që kanë marrëdhënie shitblerjeje me institucionet shtetërore. Implementimi i kësaj faze ka filluar në 01.01.2021.
- Faza e dytë (B2B), e cila përfshinte përpilimin elektronikisht të faturave tatimore midis subjekteve private që kanë një marrëdhënie shitblerjeje dhe pagesa/arkëtimi kryhet pa para në dorë (vetëm me bankë). Implementimi i kësaj faze ka filluar në 01.07. 2021. Të gjithë tatimpaguesit e regjistruar që do t'i lëshojnë një faturë tatimore një subjekti tjetër privat do të realizohet nëpërmjet sistemit të fiskalizimit.
- Faza e tretë (B2C), përfshinte përpilimin elektronikisht të faturave tatimore për subjektet që kanë një marrëdhënie shitblerjeje me subjekte private dhe konsumatorët finalë. Implementimi i kësaj faze filloi në 01.09. 2021. Të gjithë tatimpaguesit e regjistruar që do t'i lëshojnë një faturë tatimore një subjekti privat dhe subjekt privat me konsumatorin final, do të realizohet nëpërmjet sistemit të fiskalizimit. Në këtë fazë pagesa dhe arkëtimi bëhet vetëm me para në dorë.

Në muajin shtator nisi zbatimin procesi i fiskalizimit për biznesin e vogël, që vlerësohet faza më e vështirë, për shkak të numrit të lartë të subjekteve që kryejnë transaksione me para në dorë. **Ndërsa faza e dytë, për bizneset që mes tyre kryejnë transaksione pa para në dorë nisi zbatimin nga 1 korriku. Në këtë fazë kishin detyrimin të fiskalizoheshin 34,000 subjekte (nga 51,000 që deklaruan fillimisht tatimet), por në përgjigjen e kërkesës për informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ky institucion shprehet se deri në datën 1 shtator 2021, vetëm 24.446 biznese që kishin detyrim përmbylljen e procesit të fiskalizimit në fazën e dytë, e kanë realizuar atë.**

Në total, në të treja fazat kanë pasur detyrim për të kryer procesin e fiskalizimit 120 mijë subjekte, nga të cilat vetëm 30% e kanë përfunduar procesin deri fund të muajit shtator. Tatimpagues të fiskalizuar në total deri në fund të muajit shtator, janë 36,847 prej 120,000 subjekte që kanë detyrimin të fiskalizohen. Sipas përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Nga nisja e procesit deri më 1 shtator, nga AKSHI-t në total janë lëshuar 65,092 certifikata elektronike, nga të cilat 19,600 janë biznes i madh dhe 44,935 janë biznes i vogël. Janë edhe 7,333 subjekte që kanë aplikuar

dhe janë në pritje të pajisjen me certifikatë elektronike. Në total, numri i faturave të lëshuara është 48,9 mln, ku 46,6 mln jane fatura të lëshuara me para në dorë dhe 2,2 mln është numri i faturave pa para në dorë.

Faza II nisi në një kohë kur shumë tatimpagues nuk ishin të pajisur me certifikatën elektronike, por pavarësisht kërkesave të tyre dhe shoqatave të bizneseve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk e shtyu afatin e zbatimit. Në ditët e para të muajit korrik, procesi u shoqërua me bllokim të portalit SelfCare (ku çdo subjekt për t'u regjistruar për fiskalizimin është i detyruar të ngarkojë certifikatën elektronike në portal) dhe me probleme praktike të zbatimit. Qeveria ndërkohë miratoi aktin normativ në ligjin për procedurat tatimore për mosaplikimin e dënimeve administrative deri më 31 dhjetor 2021. Numri i ulët i bizneseve të fiskalizuara është për shkak të keqkuptimit të aktit normativ për mosvendosjen e gjobave. Shqetësuese për ta janë edhe mjaft probleme ende të pazgjidhura të fiskalizimit, vështirësitë në ndërveprimin e bizneseve të fiskalizuara me ato të pafiskalizuara, si dhe ngadalësia me të cilën punon sistemi SelfCare. Në këtë situatë, realizimi i plotë i fiskalizimit jo vetëm që do të kërkojë kohë, por do të rrisë kostot e biznesit.

3. REZULTATET E ARRITURA DHE REZULTATET E PRITSHME

Procesi i fiskalizimit, një nga reformat më madhore që nisi zbatimin gradualisht në vitin 2021, është një sfidë për sistemin fiskal në vend. Ministria e Financave pret që zbatimi i tij të ndikojë rritjen e të ardhurave me 2-3 pikë përqindje të Prodhimit të Brendshëm Bruto (nga 26-27% e PBB-së, që është sot). Si çdo zhvillim teknologjik, procesi duhet mbështetur dhe ne periudhe afatmesme mund të kontribuojë deri diku pozitivisht në drejtim të uljes së informalitetit, rritjes së rendimentit të mbledhjes së të ardhurave tatimore dhe lehtësitë që mund të sjellë për tatimpaguesit, për thjeshtësinë e sigurinë e procesit të faturimit. Por, në afatin e shkurtër, procesi po shoqërohet me sfida të mëdha, të lidhura si me periudhën e vështirë që po kalon vendi, për shkak të krizës së Covid-19, ashtu dhe me paqartësitë e subjekteve, kryesisht të vogla dhe kohën e shkurtër në dispozicion për zbatimin.

Edhe në rast të zbatimit me sukses dhe brenda afateve kohore të fiskalizimit, pritshmëritë nuk duhet të jenë të tilla që kjo reformë të luftojë informalitetin dhe do të sjellë rritje drastike të të ardhurave në buxhet. Ekonomia e brendshme ka probleme shumë më të thella strukturore, që nuk zgjidhen aq thjeshtë. Një pengesë kryesore për rendimentin fiskal është struktura e bizneseve në Shqipëri, sipas numrit të punonjësve dhe qarkullimit vjetor, sipas aktiviteteve ekonomike, ku një pjesë të konsiderueshme e përbëjnë mikrondërmarrjet. Shqipëria karakterizohet nga një peshë e lartë e bizneseve mikro, me 1-4 të punësuar, që përbëjnë 88% të numrit të subjekteve në vend. Ndonëse zënë peshën kryesore sa i përket numrit të subjekteve, bizneset me 1-4 punonjës qarkullojnë vetëm 11% të të ardhurave totale nga bizneset, duke bërë që pjesa dërrmuese e sipërmarrjeve në vend të mos jenë domethënëse sa i përket mbledhjes së të ardhurave tatimore (këto biznese janë të përjashtuara në pjesën më të madhe nga taksat e tatimet, ndërsa nga 1 janari 2021, subjektet me qarkullim vjetor deri 14 milionë lekë janë përjashtuar nga tatimfitimi dhe deri në 10 milionë lekë nga TVSH). ***Përfshirja në fiskalizim e tyre veç do të shtojë kostot e subjekteve dhe do të ketë pak ndikim në të ardhura, ndaj ekspertët e ekonomisë këshillojnë që subjektet e vogla të mos përfshihen fare, sugjerim i cili nuk u morr në konsideratë.***

Ndonëse ka barrën më të lartë fiskale në rajon (totali i taksave dhe kontributeve në përqindje ndaj fitimit është 36.6% për Shqipërinë, sipas Bankës Botërore), Shqipëria ka rendimentin më të ulët fiskal në rajon dhe një ndër më të ulët në Europë. Kjo performancë e dobët fiskale, në krahasim me Bashkimin Europian dhe vendet e tjera të Europës, krahas dominancës së mikrondërmarrjeve, lidhet me disa faktorë kryesorë:

- Së pari, me peshën e lartë që ka bujqësia në ekonominë shqiptare, me 19% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Ky sektor është informal dhe jashtë sistemit fiskal në pjesën më të madhe.
- Së dyti, me informalitetin e lartë dhe strukturën joproductive të ekonomisë. Sipas INSTAT, tregtia është aktiviteti ekonomik që gjeneron 44% të qarkullimit vjetor, e ndjekur nga ndërtimi, me 14%. Për këtë të fundit, sfida mbetet të punohet paralelisht për uljen e informalitetit dhe rregullimin e transaksioneve barter.
- Së treti, përjashtimet e shumta tatimore në vite dhe një sistem tatimor kompleks kanë krijuar shtigje të shumta për shmangie dhe evazion fiskal, siç është konstatuar shpesh nga raportet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Nëse do të bëjmë një krahasim të të ardhurave të mbledhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimi mbi Fitimin për periudhën Janar – Qershor të vitit 2020 dhe të vitit 2021, vërehet një rritje e të ardhurave të mbledhura nga këto dy zëra në vitin 2021. Por kjo rritje kurrsesi nuk mund t'i atribuohet fillimit të ndikimit pozitiv të procesit të fiskalizimit, pasi gjashtë mujori i parë i vitit 2020 ka qënë piku i pandemisë dhe ka ndikuar në rënien e të ardhurave tatimore të mbledhura në këtë periudhë. Duhet të kalojë kohë për të parë nëse fiskalizimi do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë dhe domethënës në rritjen e të ardhurave në buxhet.

	Lloji i të ardhurave	Periudha	Gjashtë	mujore	Janar -
		2020	Qershor	2021	Qershor
A	D.P.TATIME TOTAL (Bruto)	109,475,856		133,323,538	
1	Tatimi i Vlerës së Shtuar (bruto)	20,857,442		26,853,475	
	- Tatimi i Vlerës së Shtuar (neto)	13,611,896		11,518,785	
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	7,245,546		15,334,690	
2	Tatim mbi Fitimin	13,705,185		17,664,202	
E	D.P.TATIME TOTAL (Neto)	102,230,310		117,988,849	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Më shumë sesa fiskalizimi, thjeshtëzimi i sistemit tatimor dhe lufta ndaj informalitetit mbeten parakushtet kryesore për të rritur bazën e tatimpaguesve në vend, si dhe për të rritur të ardhurat buxhetore me të paktën 3-5 pikë përqindje në afatin e mesëm, duke i çuar ato në mbi 30% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ndaj, që sistemi i ri i fiskalizimit të jetë efikas dhe të sjellë rezultatet e pritshme, duhet të shoqërohet (apo t'i ishte paraprirë) me një reformë tërësore për uljen e informalitetit, sidomos në sektorin e ndërtimit dhe atë të tregtisë në vend. Përndryshe mund të rrezikojë të jetë flluska e radhës në listën e reformave të mëdha, që nuk dhanë efekt në uljen e informalitetit, si përfshirja e bizneseve të vogla në TVSH, e cila dështoi tre vjet pas fillimit të zbatimit.

4. Problematikat e shfaqura gjatë zbatimit të fiskalizimit

Aktualisht janë shumë subjekte (sidomos të vogla) që nuk po fiskalizohen, pasi sipas tyre kanë afat deri më 31 dhjetor. Të tjerë, edhe pse janë fiskalizuar, nuk po lëshojnë fatura të fiskalizuara dhe subjektet e pajisura me certifikatë elektronike vazhdojnë të lëshojnë faturat nga blloqet tatimore. Ka edhe biznese që janë të pajisur me certifikatë elektronike dhe kanë lidhur edhe kontratë për përdorimin e zgjidhjeve softëare, por sërish nuk lëshojnë fatura të fiskalizuara. **Kjo ndodh pasi shumë biznese po përfitojnë nga faza tranzitore e mosvendosjes së gjobave. Në këtë situatë kaotike, i gjithë presioni bie mbi kompanitë blerëse që janë të rregullta dhe janë fiskalizuar. Prandaj duhet që administrata tatimore të sqarojë tatimpaguesit se çfarë nënkupton faza tranzitore, cilat janë detyrimet e subjekteve për fiskalizimin deri më 31 dhjetor dhe se çfarë do të ndodhë me ato që nuk janë fiskalizuar pas 1 janarit 2022.** Sipas Drejtorisë e Përgjithshme e Tatimeve, në kërkesën tonë për informacion thuhet se ky institucion është duke kryer çdo ditë trajnime për reformën e Fiskalizimit. "Këto trajnime, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor për zbatimin e kësaj reforme, vijojnë të zhvillohen nga e hëna - premtën në orën 12.00-14.30. Trajnimet administrohen nëpërmjet platformës Eëbex dhe janë të aksesueshme pa regjistrim paraprak dhe secili pjesëmarrës në momentin e log-imit apo gjatë zhvillimit të trajnimit duhet të vendosë edhe NIPT-in e subjektit/eve që përfaqëson. Administrata Tatimore ka angazhuar në këtë proces trajnuesit dhe ekspertët e saj më të mirë, të cilët trajtojnë çështje të ndryshme që lidhen me Fiskalizimin. Në trajnimet e zhvilluara për procesin e Fiskalizimit, për periudhën Nëntor 2020 - 23 Shtator 2021 kanë marrë pjesë gjithsej 30,491 tatimpagues dhe 3,433 kontabilistë." **Tatimet duhet të mbajnë qëndrime të drejtpërdrejta, me sqarime zyrtare të bazuara në ligj dhe udhëzim, por edhe me video në televizione që biznesi i vogël i cili nuk mund të ndjekë trajnimet online, të mësojë si funksionon procesi, pasi shumë prej tyre janë keqinformuar nga të tjerë.** Subjekte të tjera po hasin vështirësi në pajisjen me certifikatë elektronike, pavarësisht se kanë kryer aplikimin prej disa javësh. Platforma SelfCare ka shfaqur mjaft probleme dhe ndërveprimi është tepër i vështirë.

Ndër problemet kryesore që mbetet për t'u zgjidhur te biznesi i vogël është deklarimi i faturave të blerjes sipas sistemit të ri. Udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përcakton se dorëzimi i deklaratës të TVSH-së dhe librave të blerjes dhe shitjeve do të vazhdojnë të deklarohen me sistemin e vjetër deri në periudhën 31 dhjetor 2021. Librat e shitjes dhe të blerjes duhet të formatojnë në platformën SelfCare sipas formatit aktual, me qëllim që të mos krijohen probleme pas 1 janarit 2022. Nga ana tjetër, portali duhet të

formatojë librin e blerjeve dhe shitjeve, siç e kërkon ligji për TVSH-në, pasi libri është i komplikuar dhe jo në përputhje me ligjin e TVSH-së. Teksa shumë biznese, nga 34 mijë subjektet që duhet të përfshiheshin në fazën e dytë, nuk e kanë kryer ende fiskalizimin, **subjektet që kanë filluar ta zbatojnë atë, janë të paqarta nëse duhet të pranojnë faturat me blloqe, pasi tremben se nuk do t'u njihen si shpenzime të zbritshme, apo nuk do u njihet TVSh e rimbursueshme.** Subjektet ende nuk e dinë se si do të procedohet për transaksionet mes bizneseve të fiskalizuara dhe të pafiskalizuara për B2B, apo si do të bëhet deklarimi i librave të shitjes e blerjes për korrikun.

Një tjetër çështje e pazgjidhur, që ka shkaktuar paqartësi tek bizneset është se **si do të veprohet në raste të shkëputjes së lidhjes me internet, apo edhe në rastet kur biznesi e ushtron aktivitetin e tij një zonë të pambuluar me internet.** Për këtë pikë, në kërkesën tonë për informacion, Dretoria e Përgjithshme e Tatimeve shperhet: "Në rast të ndërprerjes së lidhjes së internetit, tatimpaguesi lëshon faturë si në një transaksion normal, me ndryshimin e vetëm që fatura nuk do të ketë kodin NIVF të gjeneruar nga Administrata Tatimore dhe për këtë fatura duhet të printohet në letër. Tatimpaguesi duhet që brenda 48 orëve pas momentit kur ndërpritet lidhja e internetit, të mundësojë lidhjen e internetit dhe të dërgojë të gjitha faturat e lëshuara gjatë transaksioneve offline. Për të gjitha faturat e lëshuara në mënyrë offline, Administrata Tatimore cakton një NIVF dhe ia kthen atë tatimpaguesit si konfirmim për pranimin e faturave të dorëzuara me vonesë. Nëse tatimpaguesi nuk mund të rivendosë një lidhje interneti, brenda afatit prej 48 orë, për të cilin është përgjegjës ofruesi i këtij shërbimi, ose për shkak të forcave madhore, tatimpaguesi duhet të informojë Administratën Tatimore dhe të sigurojë dokumente ose prova të tjera që demonstrojnë pamundësinë për të krijuar një lidhje interneti, sipas udhëzimeve të Ministrisë të Financave.

Në rastet kur tatimpaguesi ushtron aktivitet në një zonë të pambuluar me internet, ai duhet të sigurojë:

- Vërtetim nga AKEP për pamundësinë e lidhjes me internet.
- USB/memorie e lëvizshme për dorëzimin pranë DRT përkatëse të të dhënave.
- Formularë për regjistrimin e operatorëve, arkës apo adresave të ushtrimit të aktivitetit, të cilat duhet të dorëzohen në DRT përkatëse."

Për të gjitha problematikat e evidentuara më sipër, ekspertët fiskalë kishin kërkuar që të lihej më shumë kohë për fiskalizimin dhe ai të mos fillonte njëherësh, por të testohej me sektorë të ndryshëm, në mënyrë që të bëheshin më të qarta problemet. Ndërsa heqja e gjobave, ndërkohë që fiskalizimi filloi zbatimin ishte një masë e pamenduar dhe e pastudiuar, e cila vetëm rriti evazionit dhe paqartësinë tek bizneset, përkeqësoi edukimin e

tatimpaguesve dhe do ndëshkojë në një etapë të dytë me mijëra biznese. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës në një përgjigje drejtuar Ministrisë së Financave argumentonte se: “Ashtu siç kanë vepruar shumë vende evropiane, periudha e testimit të platformës të faturës elektronike do të duhet domosdoshmërisht të shtyhet. Është shumë e rëndësishme të evidentohen problemet dhe të mbështeten sipërmarrjet në përballimin e kostove për kualifikimin e stafit që do të aplikojë në platformën e faturave elektronike. Adoptimi i programeve të reja kompjuterike, mirëmbajtja e sistemit, kostot dhe periudha e trajnimit të stafit brenda kompanisë, ashtu edhe vetë testimi i platformës së faturës elektronike, forcon bindjen tek sipërmarrja nevojën për shtyrjen e afateve ligjore për zbatimin e kësaj reforme, përtej vitit 2021”, thuhet në shkresën e Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë.

5. KOSTOT E FISKALIZIMIT PËR BIZNESIN E VOGËL

Sipas llogaritjeve të “Monitor”, bazuar te çmimet e kompanive të tregtimit të kasave dhe të zgjidhjeve softëare, në një biznes i vogël do të zgjedhë të përditësojë kasën për fiskalizimin me çmimet minimale, kostoja llogaritet 138 euro. Në këtë variant, përfshihet përditësimi i kasës 50 euro, mirëmbajtja 41 euro/vit, karta e internetit 15 euro/vit, nxjerrja e certifikatës së sigurisë 32 euro/vit. Me variantin e çmimeve maksimale, kostoja llogaritet 227 euro. Konkretisht azhurnimi i kasës 120 euro, mirëmbajtja 60 euro/vit, karta e internetit 15 euro/vit, nxjerrja e certifikatës së sigurisë 32 euro/vit. Nëse biznesi zgjedh të blejë kasë të re, që nuk nevojitet të përshtatet me sistemin e ri të faturimit, kostoja do të jetë 348 euro në total. Kasa e re kushton 240 euro + 41 euro/vit mirëmbajtja + 15 euro/vit karta e internetit + 32 euro/vit certifikata e sigurisë. Shpenzimet vjetore do të jenë 98 euro (mirëmbajtje e kasës, certifikatë dhe internet).

Kostot për biznesin e vogël që do përdor zgjidhje software	
VARIANTI I	
Kostoja kur përdoret tablet	
Blerja e tabletit	82 euro
Blerja e zgjidhjes software	82 euro
Interneti	100 euro/vit
Certifikata e sigurisë (çdo vit)	33 euro/vit
Printeri termik	82 euro
Totali	380 euro
VARIANTI II	
Kostoja kur përdoret kompjuter	
Blerja e kompjuterit	165 euro
Blerja e zgjidhjes software	82 euro
Interneti	100 euro/vit
Certifikata e sigurisë (çdo vit)	32 euro/vit
Printeri termik	82 euro
Totali	462 euro

Për bizneset që do të përdorin zgjidhjet softëare, llogaritet se kostoja që do të bëjë llogarit blerjen e kompjuterit apo tabletit që kushton 10,000-20,000; zgjidhjes softëare 10,000; printeri termik 10,000 dhe interneti 12,000 lekë/vit për linjë të vogël dhe 4,000 lekë/vit certifikata e sigurisë kostoja do të jetë 46,000 lekë (380 euro) nëse zgjidhjen softëare e instalon në tablet dhe 56,000 lekë (462 euro) nëse e instalon në kompjuter.

Burimi: Llogarotje nga Revista Monitor referuar cmimeve te tregut.

Gjetjet kryesore



Në total, në të treja fazat kanë pasur detyrim për të kryer procesin e fiskalizimit 120 mijë subjekte, nga të cilat vetëm 30% e kanë përfunduar procesin deri fund të muajit shtator. Konkretisht, tatimpagues të fiskalizuar në total deri në fund të muajit shtator, janë 36,847 prej 120,000 subjekte që kanë detyrimin të fiskalizohen.



Faza e dytë, për bizneset që mes tyre kryejnë transaksione pa para në dorë nisi zbatimin nga 1 korriku. Në këtë fazë kishin detyrimin të fiskalizoheshin 34,000 subjekte (nga 51,000 që deklaruan fillimisht tatimet), por vetëm 24.446 biznese që kishin detyrim përmbylljen e procesit të fiskalizimit në fazën e dytë, e kanë realizuar atë.



Miratimi i aktit normativ për heqjen e gjobave deri më 31 dhjetor 2021 ka ngadalësuar ecurinë e procesit. Problemet me platformën SelfCare dhe vështirësitë me ndërveprimin mes bizneseve, kanë zgjatur në mënyrë të paparashikuar zbatimin në kohë të fiskalizimit.



Numri i ulët i bizneseve të fiskalizuara është për shkak të keqkuptimit të aktit normativ për mosvendosjen e gjobave. Shqetësuese për ta janë edhe mjaft probleme ende të pazgjidhura të fiskalizimit, vështirësitë në ndërveprimin e bizneseve të fiskalizuara me ato të pafiskalizuara, si dhe ngadalësia me të cilën punon sistemi SelfCare.



Ekspertët fiskalë kishin kërkuar që të lihej më shumë kohë për fiskalizimin dhe ai të mos fillonte njëherësh, por të testohej me sektorë të ndryshëm, në mënyrë që të bëheshin më të qarta problematikat. Ndërsa heqja e gjobave, ndërkohë që fiskalizimi filloi zbatimin ishte një masë e pamenduar dhe e pastudiuar, e cila vetëm rriti evazionit dhe paqartësinë tek bizneset, përkeqësoi edukimin e tatimpaguesve dhe do ndëshkojë në një etapë të dytë me mijëra biznese.



Fiskalizimi rriti kostot e bizneseve të vogla duke filluar nga 380 deri në 460 Euro. Por këto nuk janë kostot e vetme që i shtohen biznesit të vogël, pasi ata duhet të investojnë në rritjen e kapaciteteve të stafit ekzistues apo të punësojnë staf shtesë për t'i asistuar me procedurat e fiskalizimit.

Rekomandime

- ✓ **Drejtoria e Tatimeve duhet të mbajë qëndrime të drejtpërdrejta, me sqarime zyrtare të bazuara në ligj dhe udhëzim, por edhe me video në televizione që biznesi i vogël i cili nuk mund të ndjekë trajnimet online, të mësojë si funksionon procesi, pasi shumë prej tyre janë keqinformuar nga të tjerë.**
- ✓ **Që sistemi i ri i fiskalizimit të jetë efikas dhe të sjellë rezultatet e pritshme, duhet të shoqërohet (apo t'i ishte paraprirë) me një reformë tërësore për uljen e informalitetit, sidomos në sektorin e ndërtimit dhe atë të tregtisë në vend.** Përndryshe mund të rrezikojë të jetë filluska e radhës në listën e reformave të mëdha, që nuk dhanë efekt në uljen e informalitetit, si përfshirja e bizneseve të vogla në TVSH, e cila dështoi me sukses, tre vjet pas fillimit të zbatimit.
- ✓ **Ndonëse ka barrën më të lartë fiskale në rajon (totali i taksave dhe kontributeve në përqindje ndaj fitimit është 36.6% për Shqipërinë, sipas Bankës Botërore), Shqipëria ka rendimentin më të ulët fiskal në rajon dhe një ndër më të ulët në Europë. Kjo performancë e dobët fiskale, në krahasim me Bashkimin Europian dhe vendet e tjera të Europës, krahas dominancës së mikrondërmarrjeve, lidhet me disa faktorë dhe fiskalizimi nuk mund të sjellë rritje domethënëse të rendimentit fiskal në Shqipëri. **Kështu rekomandohen ti kushtohet vëmendje e veçantë uljes së informalitetit në bujqësi që përbën 18% të PBB, rregullimin e transaksioneve barter uljes së kompleksitetit të sistemit tatimor që krijon hapësira për evzion fiskal.****
- ✓ **Për të gjitha problematikat e evidentuara gjatë kësaj periudhe rekomandohet të lihet më shumë kohë në dispozicion për përfundimin e procesit.** Është shumë e rëndësishme të evidentohen problemet dhe të mbështeten sipërmarrjet në përballimin e kostove për kualifikimin e stafit që do të aplikojë në platformën e faturave elektronike. Adoptimi i programeve të reja kompjuterike, mirëmbajtja e sistemit, kostot dhe periudha e trajnimit të stafit brenda kompanisë, ashtu edhe vetë testimi i platformës së faturës elektronike, e bën të pashmangshëm shtyrjen e afateve ligjore për zbatimin e kësaj reforme, përtej vitit 2021

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

RAPORT MONITORIMI
FINANCAT & EKONOMIA
Gusht-Tetor 2021